






MODELI 3D I QYTETIT TË GJIROKASTRËS
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga zjarri

Në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ASIG ka kryer analizimin e ndryshimeve të ndodhura në ngjarjet e fatkeqësive natyrore nga zjarri të cilat prekën zonat: “Beden, Kavajë”, “Horë-Vranisht, Himarë”, “Sinë e Sipërme, Dibër”, “Turan, Tepelenë”, dhe “Xeth, Fushë Arrëz”. Me anë të përdorimit të teknologjisë së avancuar Remote Sensing, u ndërtuan hartat e zonave të prekura nga zjarri duke shtuar elemente, të cilët janë të rëndësishëm për:

- Vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e riskut nga zjarri;
- Marrjen e masave strukturore për zvogëlimin e riskut;
- Vlerësimin e dëmit nga zjarri.

Këto produkte gjeohapësinore përforcojnë kapacitetet institucionale për menaxhimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen e komunitetit.




Publikohet Informacion Gjeohapësinor për temën “Kufijtë e Njësive Administrative”

ASIG në bashkëpunim me Bashkinë Patos, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresën:


- Rendi 4 (Kufi njësie administrative), Bashkia Patos.

Kufijtë e përditësuar janë miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Patos, nr. 36, datë 30.10.2024, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të Bashkisë Patos”, në zbatim të nenit 93, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 1078, datë 23.12.2015, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, Tema: Kufijtë e njësive administrative”.



Zgjerimi i Hartës Bazë – Zona Ballë (Përmet).



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Ballë në Bashkinë Përmet. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 4.9 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180. Përpunimi i të dhënave, strukturimi i gjeodatabazës, kontrolli i saktësisë pozicionale si dhe verifikimi në terren i elementeve të paqartë hartografikë, është realizuar sipas manualeve përkatëse për krijimin e hartave topografike digjitale të shkallës 1:2000.

Rilevim me teknologjinë UAV - Zona Gjirokastër

Në funksion të përmirësimit të planifikimit urban dhe administrimit të territorit, ASIG ka kryer një rilevim fotogrametrik të zonës urbane të qytetit të Gjirokastrës me teknologjinë UAV (Unmanned Aerial Vehicle). Ky rilevim mbulon një sipërfaqe prej 11.6 km² me rezolucion 4 cm, gjë e cila garanton cilësi të lartë dhe detaje të imta për analizat gjeohapësinore në mjedisin urban. Në vijim të procesit, u krye edhe një mision fotografimi me metodën oblique, e cila mundëson imazhe me kënde të ndryshme, duke ofruar pamje reale dhe detaje të sakta të terrenit dhe objekteve.


Produktet e ofruara përfshijnë:

- Ortofoto;
- DSM (Modeli Digjital i Sipërfaqes);
- DTM (Modeli Digjital i Terrenit);
- Izoipse.

Ortofoto




Modeli digjital i sipërfaqes



Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin rrugëve urbane të qytetit të Gjirokastrës me një gjatësi të mbuluar me fotografi 360° prej 70 km. Të dhënat vizuale janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar duke ofruar një panoramë të detajuar të infrastrukturës rrugore në këtë qytet. Ky informacion vizual shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane – Gjirokastrë




PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

ASIG merr pjesë në Asamblenë Shkencore të Shoqatës Ndërkombëtare të Gjeodezisë

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në Asamblenë Shkencore të Shoqatës Ndërkombëtare të Gjeodezisë e zhvilluar në datat 1-5 shtator 2025, në Rimini, të Italisë. Në këtë aktivitet, ASIG prezantoi projektin “Modeli i Gjeoidit Gravimetrik dhe Hibrid të Shqipërisë – ALBGEOID2024”, i cili u vlerësua nga komuniteti shkencor ndërkombëtar, si një arritje me rëndësi të veçantë për krijimin e një reference moderne vertikale kombëtare. Aktiviteti u shndërrua në platformë shkëmbimi profesional, me ekspertë ndërkombëtarë që trajtuan ndikimet klimatike, teknologjitë moderne të matjes dhe përmirësimin e referencave globale, duke theksuar rolin aktiv të ASIG dhe të Shqipërisë, në arenën ndërkombëtare.

Publikimi i modelit kombëtar të Gjeoidit ALBGEOID2024 në serinë shkencore ndërkombëtare “IAG Symposia”

Si rezultat i prezantimit dhe vlerësimit të projektit nga komuniteti shkencor, “ALBGEOID2024”, u publikua në serinë prestigjioze “IAG Symposia” duke certifikuar besueshmërinë, cilësinë dhe vlefshmërinë e tij shkencore. Ky publikim vendos Shqipërinë në hartën e kontributeve ndërkombëtare në fushën e gjeodezisë dhe shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një infrastrukture gjeohapësinore kombëtare të unifikuar dhe të besueshme.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Me qëllim rritjen e kapaciteteve në menaxhimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, ASIG organizoi trajnime të dedikuara për stafet teknike të institucioneve të mëposhtme:

- Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës–Kanalizime Durrës - 16 shtator 2025;
- Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës–Kanalizime Korçë - 22-23 shtator 2025.

Trajnimet u fokusuan në krijimin dhe standardizimin e të dhënave të rrjetit të ujësjetllës-kanalizimeve sipas standardit teknik të gjeonformacionit “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”.

Gjithashtu, më 19 shtator 2025 u zhvillua trajnimi me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), ku u trajtuan aspekte të përdorimit praktik të Gjeoportalit Kombëtar për kërkim tematik, vizualizim të të dhënave dhe menaxhim të aksesit të informacionit gjeohapësinor.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Satelitët dhe smart data në shërbim të bujqësisë evropiane

Në Reims u mbajt Konferenca e Komunitetit të IACS – ICE 2025, e cila theksoi avancimin e Sistemeve të Monitorimit të Sipërfaqeve (Area Monitoring Systems–AMS) dhe konsolidimin e Sistemit të Administrimit dhe Kontrollit të Integruar (Integrated Administration and Control System–IACS). Ky i fundit, përfshin Aplikacionin Gjeohapësinor për Subvencionet (Geospatial Aid Application–GSA) dhe Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (Land Parcel Identification System–LPIS), duke mbuluar mbi 90% të tokës bujqësore të BE-së; vetëm në vitin 2024, AMS mundësoi korrigjime në mbi 3 milionë ha. Prioritetet pas 2027 përfshijnë Sistemin Evropian të Monitorimit të Tokës (European Land Monitoring System–ELMS), zgjerimin e Vëzhgimit të Tokës (Earth Observation–EO), qasjen “farmer-centric” për pronësinë e të dhënave dhe vazhdimësinë e Copernicus Sentinel-2.

Misione të reja për motin hapësinor në shërbim të sigurisë gjeohapësinore

NASA dhe Administrata Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike (National Oceanic and Atmospheric Administration–NOAA) kanë lëshuar tre satelitë për të përmirësuar parashikimet e motit hapësinor dhe kuptimin e ndikimit diellor. Pas testeve, satelitët do të pozicionohen në pikën L1 (Lagrange 1) mes Tokës dhe Diellit, për monitorim të vazhdueshëm të erës dhe shpërthimeve diellore; të dhëna thelbësore për Sistemet Globale të Navigimit Satelitor (Global Navigation Satellite Systems–GNSS) dhe Sistemin e Pozicionimit Global (Global Positioning System–GPS), si edhe për komunikimet satelitore, rrjetet e energjisë dhe shërbimet gjeohapësinore. Të dhënat 24/7 do të mundësojnë paralajmërime të hershme dhe menaxhim më të mirë të rrezikut për infrastrukturën kritike.

AKTIVITETE NË VIJIM

INTERGEO 2025

Nga data 7–9 tetor 2025, në Frankfurt, të Gjermanisë, do të zhvillohet panairi ndërkombëtar INTERGEO 2025, aktivitet mjaft i rëndësishëm për gjeodezinë, informacionin gjeohapësinor dhe menaxhimin e tokës. Panairi do të mbledhë ekspertë dhe institucione nga fusha si: GIS, fotogrametria, sensorët në distancë, dronët dhe qytetet inteligjente, duke promovuar zgjidhje për sfidat globale, si ndryshimet klimatike dhe urbanizimi i qëndrueshëm.

7 - 9 Tetor 2025

ESRI SUMMIT 2025

Nga data 18–20 nëntor 2025, në Frankfurt, të Gjermanisë, do të zhvillohet Esri European Developer & Technology Summit, një aktivitet i fokusuar në inovacionet dhe aplikimet e teknologjisë gjeohapësinore (GIS). Konferenca përfshin sesione teknike dhe diskutime mbi zgjidhje të avancuara GIS, duke mbështetur krijimin e sistemeve të qëndrueshme, të sigurta dhe efikase për menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore.

18- 20 Nëntor 2025

SDQ Conference

EuroGeographics dhe EuroSDR organizojnë nga 20-21 nëntor 2025, në Athinë, të Greqisë, Konferencën për Cilësinë e të Dhënave Gjeohapësinore. Aktiviteti do të mbledhë ekspertë të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit mbi saktësinë, sigurinë dhe ndërveprueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, si dhe përdorimin e tyre në monitorimin mjedisor, qytetet inteligjente, menaxhimin e emergjencave dhe inteligjencën artificiale.

20 - 21 Nëntor 2025

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al